



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 123, Datë 19.06.2024

MBI

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËKESËS SË SHOQËRISË  
“NOVA PROSPECT” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT  
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.06.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1488/1 prot, datë 11.06.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Nova Prospect” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria “Nova Prospect” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1448 prot., datë 03.06.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 22960, Njësia Administrative Pilur, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 gërmat “a” dhe “c”; për pikën 2.1 gërmat “b”, “d”, “e” dhe “f”.
- Për sa më sipër është konstatuar se nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni si vijon:

## **NENI 9**

### **Formati dhe dokumentacioni për aplikim**

#### *Pika 1.2*

- **gërma “a”**: Shoqëria duhet të shtojë në objektin e veprimtarisë së saj dhe prodhimin e energjisë elektrike.

#### *Pika 1.3.*

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të dokumentojë në ERE mbështjetjen financiare për vlerën e mbetur, referuar përcaktimeve të planit të biznesit, si dhe të depozitojë pëlqimin apo qëndrimin e MIE-s në lidhje me transferimin e të drejtave që rrjedhin nga kontrata e nënshkruar me MIE-n, e cila është vendosur si një mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e kredisë bankare.

#### *Pika 2.1*

- **gërma “a”**: Shoqëria duhet të plotësojë të dhënat mbi llojin e centralit, on shore apo off shore, si dhe të paraqesë në ERE dokumentacionin teknik mbështetës në lidhje me jetëgjatësinë e pritshme të centralit fotovoltaik.
- Në kuadër të vlefshmërisë së VNM-së Paraprake (deri më 17.08.2024) dhe referuar faktit që shoqëria në shtojcën 2 ka deklaruar se viti i ndërtimit të centralit është 2023-2024 dhe data e fillimit të operimit 30.08.2024, ajo duhet të dokumentojë në ERE fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit fotovoltaik apo fazën në të cilën ndodhet realizimi i ndërtimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Nova Prospect” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale Nr. 2960, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Nova Prospect” shpk dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**